

Tiranë më 12.03.2024

Të nderuar Zotërinj Gjygtar.

Që në fillim do të thoja se, jam plotësisht dakort me argumentat ligjore që paraqiti avokati Idajet Beqiri për dërgimin e çështjes penale që i përket vrasjes së bashkëshortit tim Aleks Nika, për kompetencë në SPAK. Është i vetmi institucion tek i cili ne si familje kemi besim, se çështjen do ta hetojë në mënyrë të gjithanshme dhe me objektivitet.

Tani që në dispozicion të kësaj Gjykate, është vënë edhe Vendimi i Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut e Strasburgut çështja Nika kundër Shqipërisë, besojmë se është krijuar baza ligjore që hetimi i kësaj çështje të kalojë për kompetencë në SPAK. Nuk do të doja që të përsërisja argumentat ligjorë që paraqiti avokati ynë, referuar përmbajtjes së këtij vendimi. Megjithatë interes më të madh për përcaktimin e kompetencës që çështja të kalojë në SPAK, paraqesin argumentat e parashtuara, në Vendim në pikat 15,17,18,25,27,31,36,37,39,44,49,56,63,69,81,82,87,96,102 ,107 ,109, 111,114,116, 155,163.Në përfundim në unanimitet, Gjykata është shprehur se;

1. Bashkon në themel kundërshtimin e Qeverisë për mosshkrimin e mjeteve juridike të brendshme dhe e rrëzon atë.
2. Deklaron kërkesën e pranueshme.
3. Vendos se ka pasur shkelje të aspektit procedural të Nenit 2 të Konventës.
4. Vendos se ka pasur shkelje të aspektit thelbësor të Nenit 2 të Konventës.

Të nderuar Zotërinj Gjyqtarë;

Ne si familje e Aleks Nikës disponojmë një mikrokasetë, ku janë të regjistruara të gjithë komunikimet me zë, të komandantit të gardës Ndrea Prendi me personelin drejtues të Gardës së Republikës, me datën 21 Janar 2011. Përmbajtjen e të gjithë regjistrimit, e kemi dëgjuar nëpërmjet diktofonit, ne pjesëtarët e familjes. Një pjesë e vogël e regjistrimit, ku pasqyrohen urdhërat e dhëna nga Komandanti i Gardës Ndrea Prendi, janë bërë të njohura për publikun nga gazetari Artan Hoxha. Ky regjistrim në dijenin tonë është administruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka çështjen në hetim.

Tek ne familjarët e Aleks Nikës është krijuar bindja absolute, që vrasja e tij dhe tre personave të tjerë, si dhe tentativa për vrasjen gjashtë demonstruesve me armë zjarri në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" atë ditë, është realizuar në zbatim të urdhërave të dhëna nga Komandanti i Gardës Ndrea Prendi në radion e tij. Të gjithë personat e zinxhirit komandues të gardës, që kanë marrë urdhrat për të qëlluar me armë zjarri me fishekë luftarak demonstruesit që ishin në bulevard, janë evidentuar në regjistrimin e bërë në mikrokasetën që ne disponojmë. Këtë mikrokasetë ne familjarët do ta dorëzojmë vetëm në SPAK, që është institucioni kompetent për të hetuar krimin shtetëror, dhe tek i cili ne akoma besojmë se do të zbulojë të vërtetën e kësaj ngjarje.

Përmbajtja e kësaj kasete, bën të domosdoshme, kryerjen e shumë veprimeve hetimore nga SPAK, të cilat me siguri do të çojnë në zbulimin e provave të reja dhe zbardhjen e së vërtetës, për të gjithë vrasjet dhe plagosjet e kryera me armë zjarri në bulevardin para kryeministrit. Këtë kërkon të realizojë edhe Vendimi i Gjykatës së Strasburgut, në konkluzionet e tij. Ashtu sikurse Gjykata e Strasburgut edhe ne kemi studjuar me shumë kujdes të gjithë materialet e dosjes hetimore dhe gjyqësore të kësaj çështje penale.

Ne duam që të zbulohen dhe penalizohen urdhëruesit e vrasjeve, sepse janë ata që menjëherë pas ngjarjes, kanë vepruar në mënyrë të organizuar në prishjen e provave, në paraqitjen e provave të rreme, në kryerjen e veprimeve konkrete duke penguar prokurorinë në zbatimin e detyrave të saja ligjore.

Me dërgimin e çështjes për kompetencë në SPAK, duke patur besim në objektivitetin e hetimit, ne do të kërkojmë në mënyrë të hollësishme kryerjen e shumë veprimeve hetimore, të cilat kemi bindjen se do të çojnë në zbulimin e këtij krimi shtetëror.

Hetimit të kësaj çështje, duhet ti nënshtrohet i gjithë zinxhiri komandues, për të cilin shprehet Gjykata e Strasburgut. Duhet të pyeten nga SPAKU, të gjithë personat që për shkak të detyrës, kanë qenë të pranishëm në Godinën e Kryeministrit, në momentin që ka ndodhur ngjarja, si dhe ata që për shkak të detyrës, kanë marrë informacione nga organet ligjzbatuese, si ish Kryeministri në detyrë Sali Berisha, ministri i brendshëm Lulëzim Basha, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Hysni Burgaj, Drejtori i Policisë së Qarkut Tiranë Saimir Muça. Po ashtu ish Presidenti Bamir Topi, Prokurorja e Përgjithshme Ina Rama, Kryetari i Shërbimit Informativ Bahri Shaqiri e tjerë. SPAK do ti kërkojmë se për çfarë duhet të japin shpjegime secili prej tyre, në zbatimin e detyrave ligjore kushtetuese që kanë patur ditën e ngjarjes.

Duhet ti nënshtrohen hetimeve të gjithë prononcimet, që këta persona kanë bërë përpara medias pas ngjarjes në lidhje me vrasjet e 21 Janarit 2011 dhe nga cilat burime zyrtare i kanë marrë të dhënat që i kanë paraqitur si fakte apo prova.

Theksojmë se transkriptimi i audio përgjimit, i bërë publik në media nga gazetari investigativ Artan Hoxha, dhe administruar nga prokuroria e rrethit Tiranë, është më se i vërtetë për ne familjarët e dëshmorit Aleks Nika, vrarë në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit". Nuk mund të heshtet ndaj urdhërdhënësve dhe ekzekutorëve, pjesëtar të zinxhirit komandues, të pranishëm në Godinën e Kryeministrit. Të dy palët urdhërues dhe ekzekutor në bashkëpunim, kanë dëgjuar mirë njëri-tjetrin edhe për faktin, që kanë qenë gjithë kohën me kufje në vesh. Komandanti i Gardës Ndrea Prendi dëgjohet mirë kur urdhëron " Të mbahen armët në dorë gati për zjarr. Të mbahen armët në dorë gati për zjarr në ajër, pastaj kur të them unë në trup. Artan dëgjon, Artan dëgjon. Artani. Dëgjoj, dëgjoj. Ndrea Prendi.-me të kaluar gardhin e telave do të hapet zjarr luftarak. Kuptova, kuptova. Ndrea Prendi. Ky është urdhri. Dashamir dëgjuat. Dy efektiv të njësisë speciale. Alfred ta,ta,ta gjakos. (Shënimi ynë) Dëgjohe të shtëna tek e tek, radhasi. Ndrea Prendi. Alfred kujdes municionin. Kujdes municionin.

Nga komandanti i Gardës Ndrea Prendi i jepen urdhëra edhe personave të tjerë oficerë me emër, të grupit të njësisë speciale, që për të ruajtur sekretin nuk i bëjnë publike. Përmenden edhe pseudonime dhe numërtime, të këtij zinxhiri komandues oficerë të gardës, marrin urdhëra nga Komandanti I Gardës Ndrea Prendi edhe pasi janë realizuar vrasjet e katër dëshmorëve të Atdheut jashtë gardhit rrethues të Kryeministrit, brenda disa sekondave. Njëri nga drejtuesit e Policisë së Shtetit, që ishte në të njëjtat valë të radios, me Ndrea Prendin, përmend edhe ministrin e punëve të brendshme, që kërkonte menjëherë pas vrasjeve një person të zinxhirit komandues të Gardës. Pra janë shumë persona të zinxhirit komandues që ishin në valët e radios të Ndrea Prendit që kanë dëgjuar të gjitha komunikimet midis Ndrea Prendit dhe atyre që kanë qëlluar të cilët ne do ti kërkojmë SPAK që ti ripyet. Ka edhe prova shkresore, që konfirmojnë dhënien e urdhërave, por në mënyrë të cunguar, që dihet kush janë konkretisht dhe duhet të pyeten.

Duke përfunduar, shpresojmë që gjykata të pranojë kërkesën tonë për dërgimin e çështjes për kompetencë në SPAK që është i vetmi institucion që ne kemi besim se do të realizoj hetime objektive dhe të gjithanshme, që kërkon edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në Strasburg.

Bashkëshortja e Aleks Nikës

Rajmonda Nika